



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.969/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e Diellza Lubishtani kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Pranohet pjesërisht** i bazuar apeli Anr.969/2021, paraqitur nga Diellza Lubishtani kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjilanit
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Gjilanit, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje në Vendvotimin VV 04D02/01D, në Komunën e Gjilanit.
- III. **Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrat Votimeve, të vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.
- IV. **Refuzohet e pabazuar** pjesa e apelit e paraqitur nga kandidatja Diellza Lubishtani kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet KQZ-ja, për ti rinumëruar fletëvotimet në Vendvotimet VV 0407D/01 dhe VV 0407D/04, në Komunën e Gjilanit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal Diellza Lubishtani nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë,

dega në Komunën e Gjilanit në të cilën pretendon se në vendvotimet VV 04D02/01D ka pasur shkelje të së drejtës së votës pasi që sipas saj në atë klasë kanë votuar 6 votues për subjektin politik LVV dhe as subjekti as apellesja nuk ka marrë asnjë votë dhe në vendvotimet VV 0407D/01 dhe VV 0407D/04 dyshon se ka pasur ndikim në rezultatin përfundimtar prandaj edhe ka kërkuar nga PZAP që të bëhet rinumërim për vendvotimet e cekura si ne apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryera nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatja për Kuvend Komunal Diellza Lubishtani kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në VV 04D02/01D, VV 0407D/01 dhe VV 0407D/04, në Komunën e Gjilanit, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Vendvotimit të vendosur si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se nga verifikimi i të dhënave zyrtare të ofruara nga KQZ rezulton se në vendvotimin VV 04D02/01D, në Komunën e Gjilanit kandidatja Diellza Lubishtani ka gjithsej tri vota, andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi

të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete, pretendimet e saj mbeten vetëm ne suaza te dyshimeve. Pritjet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur, si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.969/2021 më datën 07.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.